

VENDIM
Nr. 87, datë 19.5.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “FAVINA 1” SHPK, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS ME NR. 402, SERIA P18, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 83, DATË 6.4.2018, PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “VOSKOPOJË”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1970 kw

Në mbështetje të neneve 16 dhe nenit 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 10, pika 3 dhe nenit 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, dhe pika 3, të “Rregullores së organizimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.5.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për modifikimin e licencës së shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Favina 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 650, datë 22.4.2020, ka përcjellë kërkesën për modifikimin e licencës nr. 402, seria P18, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 6.4.2018, “Për licencimin e shoqërisë ‘Favina 1’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Voskopojë”, me kapacitet të instaluar 1970 kw.

- Shoqëria parashtron se kërkesa për modifikimin e licencës së sipërcituar vjen si rezultat i prurjeve të mëdha të lumit të Voskopojës, i cili shkakton rritjen e kapacitetit, nga 1970 kw, në 2400 kw.

- Shoqëria “Favina 1” sh.p.k., është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në datën 24.10.2005, me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Në objekt të veprimtarisë së tij kjo shoqëri ka: Prodhimin e energjisë elektrike nga centralët elektrike ekzistues me kapacitet ekzistues të përgjithshëm jo më të madh se 5 mw.

- Nga analizimi i të dhënave teknike për HEC-in, të përcjellë nga shoqëria “Favina 1” sh.p.k., vërehet se, ndryshimi konsiston vetëm në rritjen e kapacitetit të instaluar nga 1970 kw, në 2400 kw.

- Aplikimi i shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës: është plotësuar tërësisht.

- Neni 15, pika 4, germa “b”: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence: është plotësuar tërësisht.

- Neni 15, pika 4, germa “c”: Miratimi i modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës, kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera: është pa plotësuar. Nga shoqëria nuk janë depozituar në ERE lejet nga institucionet e tjera (leje mjedisore, leje e shfrytëzimit të ujit, pika e lidhjes me rrjetin, të përditësuara me kapacitetin e instaluar, të modifikuar sipas rritjes që ka parashtruar shoqëria në këtë kërkesë dhe miratimi nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha).

- Neni 15, pika 4, germa “d”: Ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit, sipas legjislacionit në fuqi: është e pa plotësuar. Nga ana e shoqërisë nuk është dhënë informacion në lidhje me këtë kërkesë të rregullores.

- Neni 15, pika 4, germa “e”: Të ketë shlyer pagesat e rregullimit në ERE: është plotësuar tërësisht.

- Për dokumentacionin e konstatuar të munguar, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, t’i paraqesë ato në ERE, brenda afateve të përcaktuara në rregullore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., për modifikimin e licencës nr. 402, seria P18, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 6.4.2018, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Voskopojë”, si më poshtë:

- kapaciteti i instaluar nga 1970 kw, të bëhet 2400 kw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti